

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E ENJTE 27 TETOR 2022

Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Faleminderit ministres dhe përfaqësuesve të ministrisë!

E vlerësoj shumë punën e bërë qoftë në prezantimin që ministrja i bëri dje ligjit për projektbuxhetin, por edhe sot ndryshimeve në paketën fiskale! Vlerësoj edhe përpjekjet e mëdha në një situatë makroekonomike globale të vështirë, në luftën e madhe për uljen e borxhit dhe paralelisht për të mbajtur një trend të qëndrueshëm të rritjes ekonomike! Me sa vura re sot, thelbi është vënë më shumë te rritja e performancës, pra edhe ajo pjesa që interpretohet si rritje e masave penalizuese është më shumë për të rritur edhe performancën, për të pasur një rritje të ardhurash.

Do të doja të dija nëse është bërë ndonjë analizë (dakord jam me rritjen e këtyre penaliteteve, që në disa raste ose në të gjitha rastet, edhe në mënyrë të padukshme, çojnë në rritje kostosh për njësitë e produkteve të shitura), duke pasur parasysh historikun se çfarë efekti do të kenë këto penalitete, efektet në rritjen e të ardhurave, se ndryshimet fiskale i thanë, por ndryshimet në rritjen e kostove për njësi, se mos bëhemi shumë të rrezikshëm te kjo pjesë dhe nuk bëhemi konkurrentë në rajon, pra humbim atë efektin e të qenit konkurrent në rajon.

Këtu do të doja të përdorja një fjali për pak humor: “Të mos ia marrim asaj lope edhe atë qumësht që do t’ia japë viçit, se ai viçi nesër do të na japë sërish qumësht”. Pra, unë do të doja të dija nëse është bërë ndonjë analizë se çfarë efektesh do të kenë në të ardhurat e pritshme këto rritje kostosh, jo për vitin 2023, por më tej. Pastaj kur të na vijë paketa fiskale do të kemi edhe kërkesat e tjera. Një gjë që unë e kam kërkuar gjithnjë, se pashë që kishte edhe ndryshime te ligji nr. 8438, datë 28.10.1998, a mos ka ardhur koha që të bëhet një ligj i ri? E kam kërkuar gjithnjë dhe më është thënë që po punohet për një ligj të ri. Kur mund të kemi një numër tjetër ligji? Faleminderit!